

VENDIM
Nr. 193, datë 22.12.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI UNIVERSAL PËR KATEGORINË
KLIENT – OBJEKTE KULTI/BASHKËSI FETARE**

Në mbështetje të neneve 16; 20, germa “c” dhe 109, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.12.2016, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike, konstatoi se:

- Nëpërmjet Shkresës nr. 390, prot. datë 29.9.2016, Komiteti Shtetëror për Kultet ka parashtruar kërkesën mbi mundësinë e ndryshimit të tarifës së energjisë elektrike për bashkësitë fetare.

- Kjo kërkesë ka gjetur mbështetjen e Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave dhe Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese nëpërmjet shkresës nr. 3791 prot., datë 16.12.2016.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për rishikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi Universal për kategorinë Klient – Objekte Kult/ Bashkësi Fetare.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë të interesuarit për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti